



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program **Qeverisja dhe udhëheqja në sektorin publik (2021/2022)**

Fakulteti	Shkencat Shoqërore Bashkëkohore
Cikli i studimeve	Cikli i dytë (Pasdiplomike)
SETK	120
Kodi	GMPS120
Titulli	Magjistër në qeverisje dhe udhëheqja në sektorin publik
Numri në arkiv i akreditimit [120]	03-1049/1
Numri në arkiv i akreditimit []	
Vendimi për fillim me punë	
Data akreditimit	29.03.2021

Përshkrimi i programit

Programi studimor Qeverisje dhe udhëheqje në sektorin publik ka qasje multidisiplinare ndaj elementeve kryesore të studimit në fushën e qeverisjes dhe udhëheqjes publike, menaxhimit, drejtësinë dhe në fushën e shkencave socioekonomike. Në korniza të programit përshkruhen dhe identifikohen konceptet themelore, parimet e qeverisjes, proceset administrative dhe ligjore, teoritë në administratën publike siç janë ata që lidhen me sjelljen njerëzore dhe institucionale, procesi i politikave publike, ekonomia në sektorin publik dhe udhëheqja e sektorit publik.

Karriera

Nëpërmjet të programit studimor studentët përgatiten për:

- Qeverisje dhe udhëheqje në sistemet organizative në sektorin publik;
- Zbatim të njohurive profesionale në përmbushjen e menaxhimit të procesit, burimeve njerëzore, buxheteve në institucionet e sektorit publik, sektori joqeveritar dhe në organizatat private;
- Të zhvilluar mendim kritik për modelin burokrat dhe të inkurajojnë dhe ndërtojnë kapacitetet për zbatim të parimeve të menaxhimit të ri publik në institucionet e sektorit publik;
- Të zhvilluar kompetenca për të udhëhequr ciklin e projektit, me theks të veçantë në menaxhimit e bazuar në rezultate dhe zbatimin e parimeve të qeverisjes së mirë;
- Të qenë në gjendje të zhvillojnë në mënyrë analitike rolin e shtetit dhe administratës publike në dekadat e fundit në Republikën e Maqedonisë Veriore dhe në shtetet në rajon;
- Të njohur tendencat dhe veprimet bashkëkohore në vend në institucionet publike dhe në udhëheqjen publike në vendet në zhvillim dhe në vendet e zhvilluara;
- Të qenë në gjendje të marrin iniciativë për të identifikuar dhe adresuar nevojat për mësim të institucioneve shtetërore dhe administratës publike;
- Aftësi dhe kompetenca për planifikim strategjik, plane të veprimit, shkruarje të aplikimeve për projekt propozime,

- vlerësim të projekteve;
• Kompetenca dhe aftësi për planifikim strategjik në sektorin publik.

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

Ka njohuri dhe të kuptuar multidisiplinar të elementeve kryesore të studimit në fushën e administratës publike dhe qeverisjes, të drejtës, shkencave socio- ekonomike;

I përshkruan dhe identifikon konceptet themelore, parimet, proceset administrative dhe ligjore, teoritë në administratën publike siç janë ata të lidhura me sjelljen njerëzore dhe institucionale, procesi i politikave publike, ekonomia në sektorin publik dhe menaxhimi I organizatave publike dhe joqeveritare;

I kupton sistemet e ndryshme të administratës publike- administratën shtetërore, menaxhimin publik dhe ndërveprimin e institucioneve dhe proceseve politike, qeverisë dhe politikave administrative;

Ka njohuri për proceset e integritit në Bashkimin Evropian nga administrata publike dhe shtetërore dhe aspektet institucionale.

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

Ti zbatojë njohuritë që kanë të bëjnë me punën e ndërlikuar të shtetit dhe administratën publike dhe të zbatojë rregulla dhe procedura të duhura;

Të punojë si nëpunës shtetëror dhe zyrtar administrativ në punët normative dhe administrative;

Të udhëheqë institucione nga sektori publik dhe joqeveritar;

Mund të demonstrojë aftësi për të përgatitur dokumente administrative, të ndihmojë në planifikimin dhe koordinimin e punës ndërinstitutionale, arkivimin, regjistrimin e lëndëve drejtuese përmes përdorimit të sistemit informacionit;

Zbatim të menaxhmentit publik financiar;

Shkrim të projekteve dhe vlerësim të projekteve në sektorin publik dhe joqeveritar;

Të zbatojë njohuri profesionale në përmbushjen e detyrave të punës në institucionet e shtetit dhe administratës publike, në organizatat private dhe sektorin civil.

Aftësitë për të vlerësuar

Ka aftësi të mendojë në mënyrë kritike dhe për t'u përfshirë në mënyrë aktive në çështjet aktuale politike në nivelet qendrore

dhe lokale;

Analizë cilësore të procesit të projekteve publike;

Vlerësim të ndikimit të projekteve në shoqëri;

Vlerësim të projekteve në sektorin joqeveritar;

Dallon dukuritë e ndryshme që lidhen me kulturën politike të një komuniteti të caktuar;

Krahason në mënyrë kritike tendencat politike në shoqëri dhe vend dhe i vlerëson ato;

Ndikimi në proceset e integritit evropian në vend.

Aftësitë e komunikimit

Është në gjendje të marrë pjesë në debat, ndërmjetësim dhe negociata duke siguruar një analizë të arsyetuar të ligjëritit politik;

Ka një aftësi koherente për të shkruar akte administrative, projekt propozime, analiza, raport konceptual;

Tregon aftësi për të komunikuar profesionalisht me më shumë njerëz në atmosferë ekipore dhe përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse.

Aftësitë e të mësuarit

Mund të përcaktojë dhe vërtetojë rolin e politikës për një shoqëri të bazuar në dije;

Mund të marrë iniciativë për të identifikuar interesat e grupeve dhe institucioneve shtetërore brenda procesit të politikës publike;

Ka aftësi për të kryer të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe vetë- edukimit në fushën e shkencës politike;

Është në gjendje të trajtojë qytetarët për institucionet e sektorit publik dhe për një shoqëri demokratike si dhe për sektorin joqeveritar.

Lista e lëndëve

Semestri 1

- [EMDP-02] [6.0 SETK] **Sistemet politike bashkëkohore**
- [CM133] [6.0 SETK] **Qeverisja publike inovative**
- [CM134] [6.0 SETK] **Mirëqeverisja dhe përgjegjësia shoqërore**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore e përgjithshme**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore profesionale**

Semestri 2

- [CM135] [6.0 SETK] **Menaxhimi i burimeve njerëzore në sektorin publik dhe joqeveritar**
- [EMPS1034] [6.0 SETK] **Zhvillimi i qëndrueshëm**
- [CM138] [6.0 SETK] **Probleme bashkëkohore në politikat publike**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore e përgjithshme**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore profesionale**

Semestri 3

- [MCDP1010] [6.0 SETK] **Metodologjia e hulumtimit**
- [CM136] [6.0 SETK] **Teoritë dhe konceptet bashkëkohore të qeverisjes**
- [MCPA2020] [6.0 SETK] **Menaxhmenti financiar publik**
- [CM137] [6.0 SETK] **Planifikimi strategjik i avancuar**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore e përgjithshme**

Semestri 4

- [MCPA4010] [30.0 SETK] **Punimi i magjistraturës**

Description of courses

Lëndë obligative

- **Sistemet politike bashkëkohore**

Qëllimet e lëndës: - Studentët të njohohen me sistemet politike në drejtim të konceptit të tyre, karakteristikat dhe zhvillimin historik; - Studentët të pajisen me njohuri themelore për teoritë dhe konceptet e sistemeve politike kryesore; - Studentët do të mësojnë koncepte bazë të klasifikimit të sistemeve politike; - Studentët të jenë në gjendje të njohin specifikat e sistemeve të caktuara politike.

- **Qeverisja publike inovative**

Qëllimi i programit të lëndës është që studentët të: • Njihen me shfaqjen, zhvillimin dhe përhapjen e qasjeve të reja për menaxhimin e institucioneve në sektorin publik me reference veçantë për menaxhimin e ri publik; • Zhvillojnë metoda të reja operationale dhe procedura qeverisëse që mund të rrisin kapacitetin e shoqërisë për tu marrë me probleme të reja si dhe ato ekzistuese; • Gjejnë mënyra të reja për të identifikuar dhe angazhuar palët e interesuara në mënyrë që të përcaktojnë dhe identifikojnë më mire problemet dhe të ndërtojnë mbështetje për gjetjen e zgjidhjeve efektive.

- **Mirëqeverisja dhe përgjegjësia shoqërore**

Nëpërmjet të kësaj lënde studentët: Do të njihen me konceptet themelore të menaxhimit me një fokus të veçantë në "qeverisjen e mirë" dhe mekanizmat e qeverisjes së mirë; Studentët do të njihen në detaje me parimet më të rëndësishme të qeverisjes së mirë: transparenca, pjesëmarrja, llogaridhënia, efikasiteti dhe efektiviteti, sundimi i ligjit; Do të adresojë në mënyrë kritike treguesit ekzistues për matjen e parimeve të qeverisjes së mirë; Ata do të jenë në gjendje të zbatojnë modelin e treguesve për matjen e parimeve specifike në një program, projekt ose institucion specifik dhe të njëjtat ti paraqesin në një mënyrë gjithëpërfshirëse.

- **Menaxhimi i burimeve njerëzore në sektorin publik dhe joqeveritar**

Menaxhimi i burimeve njerëzore (MBNJ) është një aspekt i rëndësishëm i menaxhimit organizativ. Kjo lëndë fokusohet në shprehje të shumta të menaxhimit të burimeve njerëzore në sektorin publik. Nëpërmjet kësaj lënde do të shqyrtohen teoritë dhe praktikat e MBNJ në kontekstin e faktorëve, të demokratizimit të shoqërisë, të zhvillimit të shpejtë të teknologjisë dhe të globalizimit që drejtëpërdrejtë ndikojnë në zhvillimin e MBNJ. Njëkohësisht shkoqitet edhe roli i MBNJ në organizata me theks të rekrutimit, seleksionimit dhe testimit, trajnimit, zhvillimit dhe kompensimit të burimeve njerëzore në organizatë. Gjithashtu, aktivitetet e rëndësishme të MBNJ përfshijnë edhe analizën dhe përshkrimin e vendeve të punës. Të menduarit strategjik gjatë analizës së sfidave organizative dhe kadrovike u ofron zgjidhje konkrete udhëheqësve të sektorit publik. Kjo lëndë i përgatit studentët të jenë menaxherë të suksesshëm duke ekzaminuar teoritë, praktikat dhe politikat bashkëkohore të MBNJ.

- **Zhvillimi i qëndrueshëm**

Në këtë lëndë studentët do të pajisen me njohuri të përgjithshme të cilat i referohen zhvillimit të qëndrueshëm si një koncept i ri i cili imponohet në skenën globale e cila mund të paraqesë një ndalesë në planetin Tokë. Studentët do të pajisen me dije rreth konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm, kuptimin dhe konceptin superior për zhvillimin e qëndrueshëm, ndryshimet globale për mjedisin jetësor, të kuptuarit e parimeve dhe dimensionet e qëndrueshmërisë, do të jetë në gjendje të njihet me politikën e Bashkimit Evropian rreth zhvillimit të qëndrueshëm dhe do të kuptojë se si atë në rastin e praktikës së Maqedonisë krijohen si politika të kësaj kategorie. Njohuritë e marra në këtë lëndë do të ndihmojnë shumë për të përforcuar dijet dhe njohuritë e përgjithshme për zhvillimin e qëndrueshëm në nivel ndërkombëtar, në nivel të Bashkimit Evropian dhe vendeve anëtare të saj si dhe në RMV.

- **Probleme bashkëkohore në politikën publike**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të fitojnë njohuri në lidhje me karakteristikat e menaxhimit, bazat e menaxhimit dhe procesin e menaxhimit. Pjesa e dytë do të analizojë: politikën publike, mënyrën e zhvillimit dhe zbatimit të saj, qasjet e ndryshme analitike në fazat e krijimit dhe zbatimit të saj, qasjet e ndryshme analitike në fazat e krijimit dhe zbatimit të politikës publike, teknikat e përgatitjes dhe raportimit dhe rekomandimit për një politikë të veçantë publike. Duke studiuar përmbajtjen e këtij kursi, studentët do të fitojnë njohuri dhe aftësi që mund të zbatohen praktikisht në praktikën e tyre të ardhshme të punës si analistë. Përmbajtja e çështjes përcaktohet duke

strukturuar çështjet relative për përcaktimin e agjendës politike dhe mënyrën e vendimmarrjes.

- **Metodologjia e hulumtimit**

Kjo lëndë është e dizajnuar për studentët të cilët përgatiten për punimin e tezës së magjistraturës. Qëllimet kryesore janë që studentëve t'u ofrohen mjete për conceptualizimin e tezës së tyre me qëllim të gjetjes së çështjes së hulumtimit si dhe njohjen e metodave për mbledhjen e të dhënave përmes analizës sasiore dhe cilësore. Lënda është e fokusuar tek problemet e metodave dhe teknikave sasiore, siç është analiza statistikore, tekste që janë të lidhura me teorinë dhe testimin e hipotezave. Më pastaj të rëndësishme janë, po ashtu, edhe temat për interferencë deskriptive dhe kauzale, longitudinale, studimet krahasimtare dhe studimet e rasteve. Qëllimi është analiza e të dhënave cilësore, vënia finale e të gjitha praktikave teorike dhe veprave në funksion të dizajnit të shkrimit të temës.

- **Teoritë dhe konceptet bashkëkohore të qeverisjes**

Qëllimi i lëndës është të sqarojë teorinë e menaxhimit të sektorit publik me një fokus në teorinë klasike të burokracisë deri te teorinë bashkëkohore në kontekstin e administratës publike. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet organizimit, hierarkisë, autoritetit, koordinimit, centralizimit dhe decentralizimit, delegimit dhe mbikëqyrjes. Studentët do të jenë në gjendje të njohin aspektet themelore të menaxhimit publik si një fushë shkencore dhe si një profesion, duke qenë kështu në gjendje të analizojnë aktivitetet qeveritare nga një perspective ligjore, menaxheriale dhe politike.

- **Menaxhmenti financiar publik**

Qëllimi i lëndës është që studentëve t'ua prezantojë standardet dhe praktikën në punën financiare të grupeve organizative, metodat dhe shfrytëzimin e fondeve dhe teknikave tjera për administrimin dhe përgjegjësinë me punën financiare të OG-ve. Do të përfshihet këtu edhe vështrimi i analizave dhe aspekteve teknike në kontabilitet dhe interpretimi i raporteve financiare. Koncepti i shfrytëzimit efikas të burimeve paraqet bazën e parimeve dhe procedurave si dhe mundëson vendosje të kornizës racionale për alokim të burimeve. Lënda mundëson balancim përkatës në mes teorisë dhe praktikës, vështrim të të gjitha praktikave nga studime të ndryshme dhe është e dizajnuar në atë mënyrë që të zgjojë interesin e studentëve.

- **Planifikimi strategjik i avancuar**

Kjo lëndë analizon mënyrën efektive dhe modelet bashkëkohore të planifikimit në administratën publike. Fokusi i kësaj lënde është në menaxhimin strategjik në sektorin publik ku do të analizojmë procesin e planifikimit strategjik, përcaktimin e misionit të organizatës, vlerësimin e mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm të organizatës. Identifikojmë çështje strategjike dhe strategji në organizatë, si dhe mësojmë sit ë zbatojmë dhe vlerësojmë këto plane dhe strategji.

- **Punimi i magjistraturës**

Ky modul u mundëson studentëve që të transferojnë aftësitë dhe njohuritë e tyre për kërkime dhe për të bërë detyrën më të ndërlikuar - punimin e magjistraturës. Moduli synon të jetë plotësisht praktik dhe studentët t'i fitojnë njohuritë e nevojshme, por edhe aftësitë dhe shkathtësitë që t'i qasen shkrimit të punimit. Moduli ka një rezultat kthyes - t'u mundësojë studentëve ta shkruajnë punimin e magjistraturës me vështirësi minimale dhe me një efikasitet maksimal. Lënda ka për qëllim përmirësimin e teknikave të hulumtimit dhe stilit të shkrimit të punimit, duke mbajtur llogari për ndalesën e shërbimit me mjete të palejuara, siç janë: plagjiatura dhe cenimi i të drejtave të autorit, që janë të ndaluara me Statutin e UEJL-së.

Lëndë zgjedhore

- **Evaluimi i politikave publike: modelet, teorinë dhe procedurat**

Pas përfundimit të lëndës: Do të mund të përshkruajë elementet kryesore dhe fazat e vlerësimit të politikave publike; Do të njihen me qëllimin, logjikën dhe kontekstin në të cilin kryhen vlerësimet e politikave publike; Do të mund të shpjegojë metodat bashkëkohore për vlerësimin e politikave publike; Do të fitojnë kompetencat për të analizuar në mënyrë kritike vlerësimet e politikave ekzistuese publike; Do të mund të hartojnë dhe zbatojnë vlerësim të një politike/programi të caktuar publik si dhe të paraqesin gjetjet e së njëjtës.

- **Etika në administratën publike**

Qëllimet e planprogramit të lëndës janë që studenti: - të ketë njohuri dhe ta kuptojë semantikën dhe konceptet e moralit e të etikës, standardet e sjelljes, arsyetimin moral dhe filozofinë morale; - të zhvillojë qëndrim për pozitën e moralit në jetën profesionale; - të formojë qëndrime të qarta për të drejtat dhe detyrimet e të punësuarve në administratën publike dhe atë shtetërore; - të ketë aftësi për t'u ballafaquar me situata problematike etike; - ta ketë

ndjenjën e karakterit të nevojshëm në profesionin e administratorit; - të njihet me literaturë për etikën në sferën a administrimit publik; - të ketë gatishmëri për të përdorur mjete të komunikimit dhe të respektojë standardet etike në punë në institucionet shtetërore dhe aktorëve publik.

- **Globalizimi**

- Studentët do të kenë një kuptim më të thellë rreth konceptit të globalizimit si fenomen i cili bashkon botën (Fridman).
- Do të kenë vizion për veten dhe shoqërinë në kushte të globalizimit. - Do të aftësohen për të debatuar në mënyrë inteligjente rreth globalizimit në dimensione të ndryshme, ekonomike, politike, kulturore, sociale dhe të mjedisit. - Do të aftësohen për të identifikuar pasojat e globalizimit dhe refleksionet problematike (për shembull, antiglobalizimi). - Do të aftësohen për të krahasuar perspektiva të ndryshme të globalizimit dhe për ndikimin e globalizimit në rrafshin nacional, rajonal dhe ndërkombëtar. - Do të kenë mundësi për të zhvilluar studim të strukturuar në "prodhim" apo (epi) fenomen të globalizimit.

- **Cikli i menaxhimit të projekteve: lëndë e avancuar**

Me përfundimin e suksesshëm të lëndës, studentët do të jenë në gjendje: - Të planifikojnë aktivitetet e nevojshme për zbatimin e projektit, të identifikojnë ndërvarësitë e tyre, kohëzgjatjen si dhe kostot e tyre; - Të përgatisin raportet e nevojshme dhe të kryejnë të gjitha komunikimet e nevojshme ndërmjet projektit dhe klientit, si dhe në mes të anëtarëve të ekipit dhe të aktorëve të tjerë; - Të strukturojnë projektin dhe aktivitetet e tij përbërëse; - Të përgatisin një Gantt-tabelë dhe një plan të rrjetit për projektin dhe të identifikojnë kohën më të shkurtër të nevojshme për të përfunduar projektin; - Të përdorin MS Project si një mjet në procesin e planifikimit, zbatimit dhe rishikimit të projektit; - Të përcaktojnë projektin, të identifikojnë lëminë dhe objektivat e tij, si dhe të zhvillojnë specifikat e projektit;

- **Psikologjia sociale**

Pas përfundimit të programit studentët: - mund të shpjegojnë modelet e psikologjisë sociale; - mund të anaëzojnë mënyrat e ndryshme të zbatimit të psikologjisë sociale; - mund të analizojnë se si lidhen modelet e psikologjisë sociale me perceptimin.

- **Organizatat ndërkombëtare: qeverisja dhe funksionet**

Në korniza të kësaj lënde janë përfshirë çështje teorike në lidhje me institucionet ndërkombëtare në nivelin universal dhe rajonal, zhvillimin historik, rolin, funksionet dhe komeptencat e tyre. Vëmendje e veçantë i kushtohet çështjes së rolit të tyre në zgjidhjen e çështjeve dhe problemeve kolektive në politikën globale. Fokusi është në rolin e tyre në fushat e paqes dhe sigurisë, zhvillimit ekonomik, të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të ligjit. Fokusi është vënë në organet kryesore të krijuara brenda institucioneve, të ngarkuara me realizimin e qëllimeve të përcaktuara.

- **Teoritë dhe praktikat e qeverisjes ndërkombëtare**

Qëllimi i lëndës është që studentët të kenë një pasqyrë kritike të proceseve kryesore në sistemin e qeverisjes globale. Ai përqëndrohet në analizën e teorive themelore të qeverisjes globale. Studentët do të kenë mundësinë të shqyrtojnë në mënyrë kritike mençurinë tradicionale dhe të kuptojnë në mënyrë kritike qeverisjen globale- si në teori ashtu edhe në praktikë.

- **Politika e Evropës dhe Bashkimi evropian**

Kjo lëndë ka për qëllim që të njohë studentët me kompleksitetin dhe zhvillimin e Bashkimit Evropian, dhe me këtë edhe me zhvillimin e institucioneve (politikat dhe të drejtën), natyrën e tyre dhe veçoritë, legjislacionin dhe politikat. Njëkohësisht, qëllimi kryesor është njohja e studentëve me konceptet kryesore teorike dhe zhvillimin e Bashkimit Evropian, si dhe shqyrtimin e mundësive aktuale dhe sfidave të së ardhmes, me të cilat ballafaqohet Bashkimi Evropian, para së gjithash, në raport me institucionet e tij, me politikat dhe të drejtën.

- **E drejta kushtetuese - lëndë e avancuar**

Qëllimi i programit të lëndës e drejta kushtetuese është të aftësojë studentët të fitojnë njohuri të thelluara në fushën e së drejtës kushtetuese si një degë e së drejtës dhe si një disiplinë shkencore me aftësi specifike për zbatimin e kësaj njohurie në praktikë. Për të arritur këto qëllime, programi i lëndës do të trajtojë aspektet teorike të së drejtës kushtetuese dhe pastaj do të përqëndrohet në zbatimin e tyre praktik. Duke adoptuar njohuritë e kësaj lënde studimore, studentët do të jenë në gjendje të: - kuptojnë termin dhe përmbajtjen e së drejtës kushtetuese - kuptojnë burimet e së drejtës kushtetuese - bëjë dallimin midis së drejtës kushtetuese si degë e drejtësisë dhe të drejtës kushtetuese si disiplinë shkencore - kuptojë modelet e organizimit qeveritar dhe të jetë në gjendje të përcaktojë llojin e organizatës qeveritare në Republikën e Maqedonisë Veriore - kuptojë sfidat në regullimin dhe zbatimin e dispozitave kushtetuese për të drejtat e njeriut - aftësohet për analizën e normave kushtetuese në Republikën e Maqedonisë Veriore fitojë njohuri të thelluara për sistemin kushtetues të Republikës së Maqedonisë Veriore, të

analizojë në mënyrë analitike dhe kritike problemet kushtetuese- juridike që lindin në praktikë.

- **Udhëheqja në sektorin social**

Lënda do të trajtojë konceptet dhe mjetet që lidhen me menaxhimin e organizatave shoqërore, si dhe konceptin e ndikimit kolektiv. Lënda synon t'i ekspozojë studentët në një perspektivë të menaxhimit që është një alternativë ndaj qasjeve tradicionale për menaxhimin e organizatave shoqërore- një qasje e menaxhimit social bazuar në konceptin unik të rolit profesional.

- **Shoqëria civile dhe politikat zhvillimore**

Lënda fokusohet në njohjen me teoritë e shfaqjes së shoqërisë civile, përcaktimin e hapësirës së zënë nga shoqëria civile, aktorët kryesorë, ndërveprimet me sektorë të tjerë në vend, rolin dhe strukturën e shoqërisë civile, mënyrat e punës, karakteristikat e shoqërisë qytetare në RMV dhe në rajon, strategjitë për qëndrueshmërinë e saj, si dhe mënyrat për të ndikuar në politikat dhe proceset demokratike. Në fushën e zhvillimit, kjo lëndë do të ofrojë një prezantim të koncepteve kryesore të zhvillimit, teorive dhe qasjeve, si dhe sfidat që paraqesin varfërimi dhe ngecja në zhvillim për ata që punojnë në agjencitë donatore, agjencitë shtetërore të zhvillimit, fondacione dhe institute hulumtuese.

- **Shkathtësi për menaxhimin e punëve në zyrë**

Studentët duhet të fitojnë njohuri themelore lidhur me organizimin dhe funksionimin efikas të punës në zyrë në organet shtetërore, ato vendore dhe institucionet e ndryshme dhe ndërmarrjet. Qëllimi i lëndës është që studentët të përgatiten në nivelin e duhur që të mund t'i realizojnë detyrimet në mënyrë efikase dhe me pëgjegjësi. Njohuritë e fituara nga kjo lëndë do t'u mundësojnë studentëve që më lehtë të kryejnë detyrat e punës në administratën publike.

- **Partitë politike, zgjedhjet dhe modelet zgjedhore**

Lënda u ofron studentëve njohuri të përgjithshme rreth lëvizjeve dhe ndryshimeve sociale. Bëhet fjalë për një objekt që kryen përpunimin e disa lëvizjeve themelore sociale, duke filluar me ato të cilat të gjithë ne përballemi si qytetarë dhe akademikë. Studentët do të pajisen me një literaturë të plotë nga autorë vendas dhe të huaj, të cilët do t'u mundësojnë atyre të zgjerojnë dhe zhvillojnë njohuritë e tyre në fushat e temave që janë subjekt i analizave. Qëllimet e kësaj lënde mund të theksohen si më poshtë: - të nisin dhe zhvillohen mendime kritike brenda grupit; - studentët do të jenë në gjendje të përdorin informacionin e fituar për t'i përdorur ato për dhënien e notave dhe ndërtimin e argumenteve; - zhvillimi i shkathtësive të komunikimit të studentët; - studentët kuptojnë se si po zhvillohen lëvizjet politike në vende të ndryshme anembanë botës dhe mbi këtë bazë krijojnë qëndrime kritike mbi lëvizjet politike në RMV; - studentët kuptojnë temat që përpunohen brenda shkencave politike; - studentët të jenë në gjendje të bëjnë dallimin midis demokracisë dhe sistemeve politike jodemokratike; - studentët fitojnë aftësitë e nevojshme analitike për të kuptuar dhe vlerësuar lëvizjet politike dhe fenomenet brenda dhe jashtë vendit; - studentët janë më të aftë të kuptojnë teknikat shkencore të punës me referencë të veçantë në metodën krahasuese, etj.

- **Ekonomia sociale dhe e punës**

Kjo lëndë fokusohet në ekonominë e tregut. Mbulon përcaktuesit e kërkesës dhe ofertës së tregut të punës, përcaktuesit e rrogës, dallimet në rroga mes grupeve, investimet në kapitalin njerëzor, punësimin dhe papunësimin. Qëllimi është të punohet me raste studimore të tregut të punës për vendet në tranzicion. Përmes ligjëratave dhe ushtrimeve studentët do të njoftohen me fushat kryesore të tregut të punës dhe nëpërmjet të kësaj lënde të sigurohet bazë për hulumtime origjinale në këtë fushë.

- **Problemet politike të integritit në BE**

Qëllimi i lëndës është të thellojë njohuritë në lidhje me integrimin evropian si një problem politik. Ai largohet nga debati klasik mbi forcat shtytëse të integritit evropian dhe deficitit demokratik të BE-së. Rasti adreson një numër polemikash kryesore në kërkimet e BE-së. Kjo lëndë përfshin tre tema kryesore: - Së pari, teoritë e integritit evropian dhe qeverisjen mbikombëtare: Si mund të përshkruhet dhe shpjegohet integrimi evropian? Si përdoret integrimi për bashkëpunim të mëtejshëm ekonomik dhe politik dhe si funksionon BE-ja për të promovuar veten si një lojtar kryesor në skenën botërore? - Së dyti, problemet e demokracisë dhe legjitimitetit në BE: Sa demokratik dhe legjitim është në BE sistemi politik? A është e mundur dhe e dëshirueshme që të demokratizohet Be-ja? Çfarë zgjidhjes të mundshme ka në dispozicion për të përmbushur sfidat aktuale të Komunitetit Ekonomik Evropian? - Së treti, si funksionon BE-ja si një sistem përfaqësues politik? Cilat kanale për përfaqësim dhe pjesëmarrje ekzistojnë në nivelin e BE-së? A ka ndonjë ndryshim midis BE-së dhe shteteve anëtare në këtë drejtim?